

**Dr. Endrit MUSAJ**

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

**ARKIVAT DHE DËMTIMET NGA FAKTORËT  
SHOQËRORË NË SHQIPËRI  
(djegiet, shkatërrimet dhe humbjet e dokumenteve)**

***Përmbledhje:** Krahas faktorëve fizikë, kimikë, biologjikë etj., një faktor që ndikon në dëmtimin e arkivave dhe të dokumenteve janë edhe faktorët shoqërorë, si: humbjet, shkatërrimet, djegiet, asgjësimet jo sipas kriterëve arkivore etj. Gjatë historisë së shtetit shqiptar ka periudha ku këta faktorë kanë krijuar dëme në dokumente dhe arkiva, duke filluar me Luftën e Parë Botërore për të vazhduar deri në ditët tona me format e vjedhjes së dokumente dhe shitjes së tyre apo asgjësimet jo sipas kriterëve arkivore. Nëpërmjet këtij prezantimi do të përpiqem që, me dokumente arkivore, t'i pasqyroj sadopak disa çaste mbi dëmtimet e dokumenteve në vendin tonë, të shkaktuar nga faktorët shoqërorë dhe përprjekjet që po bëhen, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si organi më i lartë i rrejtit arkivor në Shqipëri, për ta minimizuar ndikimin e këtyre faktorëve në dokumentet e Fondit Arkivor Kombëtar.*

**Fjalë kyçe:** Dokument, arkiv, asgjësim, ruajtje, DPA

**ARCHIVES AND DAMAGES FROM SOCIAL  
FACTORS IN ALBANIA  
(documents' burns, destructions and loss)**

***Abstract:** The factors that affect the damaging of archives and documents, besides the physical, chemical and biological ones, are the social factors, such as losses, destructions, burnings, disposals, etc. not according to archival criteria. There are periods throughout the history of the Albanian state where these factors destroyed documents and archives, starting with World War I and further on to the present, in the forms of theft of documents and their sale or disposal not according to archival criteria. In this presentation I will try to present with archival documents a few moments on the destruction of documents in our country caused by social factors, and the efforts that are being made by the General Directorate of Archives, as the highest authority of the archival network in Albania, to minimize the impact of these factors on the documents of the National Archival Fund.*

**Keywords:** Document, archive, disposal, preservation, GDA

Veprimtaria e organizuar arkivore në Shqipëri është e lidhur dhe ndërruar me veprimtarinë e shtetit të pavarur shqiptar. Vetëm me krijimin e tij nisi institucionalizimi i saj dhe ekzistenca e sekretari-arkivave si hallka të strukturës dhe veprimtarisë shtetërore. Që në fillimet e veprimtarisë së saj, Qeveria e Përkohshme e Vlorës me Kanunin e përtashëm të Administratës Civile të Shqipërisë më 22.11.1913 institucionalizoi krijimin e zyrave të sekretari-arkivave pranë të gjitha organeve shtetërore. Që nga ajo kohë e deri në ditët tona veprimtaria arkivore në Shqipëri ka shënuar zhvillim, por sot do të flasim për dëmtimet e arkivave dhe të dokumenteve nga faktorët shoqërorë, si: humbjet, shkatërrimet, djegiet etj., të cilat, fatkeqësisht, kanë nisur me formimin e shtetit shqiptar, nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm.

Milan Shuflai shkruan: “Mjerisht në luftën ballkanike, më 1912, kur serbët pushtuan për ca kohë qytetin (e Elbasanit - E. M.), bashkë me arkivat relativisht të reja të kadastrës dhe financës, humbën dhe të gjitha kartat e gjykatave dhe sherifeve... Një fatkeqësi e tillë gjeti dhe arkivat e Durrësit dhe të Shkodrës, ku serbët, me një vandalizëm të pashpjegueshëm, u dhanë pas veprës shkatërruese. Vetë me sytë e mi, anës detit në Durrës, përpara godinës së qeverisë së atëhershme, kam parë pirgje kartash të nxira të thëngjillëzuara ose të bëra hi”.<sup>1</sup> Edhe Ilo Mitkë Qafëzezi vërente dëmtime të arkivave e të dokumenteve në zonën e Korçës, gjatë LIB. “Batërdia më e zezë në humbje e çkatërrim dokumentash e sende arti e arkitekture është bërë, padyshim, në qytetin- gërmadhë historiknë Voskopojë të Korçës dhe në qytetin-gërmadhë Vithkuq. Të mëdha plaçkë dokumentash kanë bërë më tepër, besoj pas të thënave të popullit, grekërit e sidomos frëngjtë, pushtonjës të qarkut tonë ndër vjetet e luftës së madhe”.<sup>2</sup>

Pasojat e LIB u ndien edhe pas mbarimit të saj, kur në vitin 1919 Gjykata e Shkallës së Parë, Elbasan, njoftonte: “Gjykatësi paqtues i Gramshit, qi sot e ka qendrën në Mollas, në një letër që na dërgon, dëftën se të gjitha regjistrat janë djegur në Gramsh e s’kanë me se të veprojnë. Këto regjistra ishin djegur me largimin e ushtrisë austro-hungareze”.<sup>3</sup>

Për shkak të përpjekjeve të pamjaftueshme për sigurimin e mjediseve të përshtatshme për ruajtjen e dokumenteve, shumë dokumente shkatërroheshin duke u bërë të papërdorshme. Në vitin 1923, protoarkivisti i Ministrisë së Punëve të Brendshme njoftonte: “... aktet e vitit 1920 e 1921 mbasi ndodhen të vume mbi arka ku po ngrahen prej mijsh, dhe tue nxjerr jashta në rast të kërkimit po shkyen krejt, sa qi mas një kohe besoj se ska me mujt me u gjend asnjë”.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Ivan Loli, *Historia e Arkivave në Shqipëri 1912-1944*, (ShBL, Tiranë, 1999), f. 5.

<sup>2</sup> Po aty f. 6.

<sup>3</sup> Arkivi Qendror Shtetëror, Fondi 155, viti 1919, Dosja VII-262, fleta 34-35.

<sup>4</sup> AQSh, F. 152, V. 1923, D. 435, fl. 13.

Edhe vetë asgjësimi i dokumenteve nga institucionet shtetërore bëhej shkas për humbjen e tyre. Asgjësimi bëhej duke u nisur nga nevoja imediate e karakterit joarkivor, sepse dokumentet zinin shumë vend dhe jo nga vlera e ruajtjes. Të tilla janë kërkesa e Ministrisë e Financave drejtuar kryeministrisë më 1942, kërkesa e Këshillit e Ministrave drejtuar Mëkëmbësisë së Përgjithshme në vitin 1943 dhe vendimi i Këshillit Administrativ i Ministrisë së Arsimit. Nga procesverbalet e djegies të këtyre institucioneve, krahas dokumenteve financiare masive, shihet që ka shumë dokumente me përmbajtje të rëndësishme.<sup>5</sup> Asgjësimi lihej në gjykimin e tre punonjësve, pa pasur asnjë udhëzim dhe asnjë emërtesë të dokumenteve që do të ishin objekt i asgjësimit.<sup>6</sup>

Lufta e Dytë Botërore solli dëmtime masive të dokumenteve dhe arkivave në të gjithë vendin si pasojë e veprimeve ushtarake. Kështu, Prokuroria e Gjirokastrës më 1943 njofton Ministrinë e Drejtësisë se për shkak të operacioneve ushtarake u dogjën të gjitha aktet e Gjykatës së Paqit në Përmet.<sup>7</sup> Gjithashtu, për shkak të djegies aksidentale të akteve të arkivit në gusht të vitit 1943, Zyra Politike e Ministrisë së Punëve të Brendshme i kërkon Ministrisë së Arsimit kopjen e korrespondencës së këtij viti, që kjo Ministri ka pasur me Zyrën Politike.<sup>8</sup> Në tetor të vitit 1943 në Gjirokastrë u dogjën të gjitha dokumentet e Intendencës Financiare.<sup>9</sup> Në janar të vitit 1944 u dogjën dhe u zhdukën aktet e Zyrës së Financës në Peshkopi.<sup>10</sup>

Nga një Qarkore e Ministrisë e Punëve Botore, në prill të 1945, dërguar Zyrave të PTT në të gjithë Shqipërinë, ku kërkohet dërgimi i kopjeve të regjistrave të letrave dhe kutive me vlefte, mësojmë se pjesa më e madhe e Zyrave të PTT, nga veriu në jug, ishin djegur si godina, si pasojë e luftimeve dhe, bashkë me to, edhe dokumentet e arkivat e tyre.<sup>11</sup>

Shkatërrimit të dokumenteve gjatë LIIB nuk i shpëtuan as institucionet fetare. Famullitari i Bajzës në Shkodër “tuj kenë se ushtritë armike kanë rroposë gjithëcka deri dhe registrat e pagëzimeve”<sup>12</sup> ishte i detyruar të lëshonte dëshmi në mungesë të tyre. Gjatë luftimeve për çlirimin e Tiranës në nëntor të 1944-s u dogj krejt arkivi i Mitropolisë së Kishës Ortodokse Autoqefale.<sup>13</sup> E njëjta gjë ndodhi me arkivin e Manastirit të Ardenicës, i cili u dogj nga gjermanët.<sup>14</sup>

---

<sup>5</sup> Loli, *Historia e arkivave*, f. 117-118.

<sup>6</sup> Po aty f. 119.

<sup>7</sup> AQSh, F. 155, V. 1943, D. VII-310, fl. 1.

<sup>8</sup> AQSh, F. 195, V. 1943, D. 467, fl. 1.

<sup>9</sup> AQSh, F. 178, V. 1943, D. I-2917, fl. 1.

<sup>10</sup> AQSh, F. 178, V. 1944, D. I-3066, fl. 4.

<sup>11</sup> AQSh, F. 177, V. 1945, D. 242, fl. 1, 5, 15, 20, 21, 23, 24, 25, 26, 34, 38, 40, 43, 44, 48, 51, 53, 56, 58, 60.

<sup>12</sup> AQSh, F. 132, V. 1942, D. 73, fl. 1.

<sup>13</sup> AQSh, F. 536, V. 1945, D. 1444, fl. 1.

<sup>14</sup> AQSh, F. 536, V. 1945, D. 44, fl. 8.

Pas vitit 1945 problemi i parë ishte krijimi i Fondit Arkivor Kombëtar dhe administrimi i tij i njëzuar nëpërmjet krijimit të rrjetit arkivor. Qysh në vitin 1946 bëhen përpjekjet e para për krijimin e Arkivit të Shtetit, megjithëse kjo u arrit vetëm më 1949. Pavarësisht prej përpjekjeve për konsolidimin e rrjetit arkivor në Shqipëri, rastet e dëmtimeve masive të dokumenteve vazhduan. Në një relacion të Institutit të Studimeve dërguar Këshillit të Ministrave më 1947, thuhet “në tregun e Tiranës... këto ditë asht shit si kartë ambalazhi me kuintal, material turqisht i arkivës së Prefekturës së Tiranës dhe material arkival që i përket kohës së okupacionit Italian në provincën e Prefekturës së Tiranës dhe të Ministrisë së Financave”.<sup>15</sup>

Por rreziku më i madh që i kërcënonte dokumentet e periudhave të paraçlirimit, në vitet e para pas çlirimit, qe grumbullimi i tyre si “letra të vjetra” dhe eksportimi në Jugosllavi “për tu bërë letër e mirë për përdorim”.<sup>16</sup>

Në një letër datë 10.12.1947 të Ministrisë së Shëndetësisë dërguar Këshillit të Ministrave, ndër të tjera, thuhet: “Të gjitha aktet e ndryshme që ndodheshin në arkivën e këtij dikasteri (me përjashtim të akteve të viteve 1945, 1946 e 1947)... u grumbulluan dhe ju dërguan Ministrisë së Industrisë... e cila mbasi t’i rregullojë t’i dërgojë në Jugosllavi për t’u bërë letër e mirë për përdorim”.<sup>17</sup>

Sipas relacioneve të Arkivit të Shtetit, në vitin 1951 në Durrës ishin 12 depo me dokumente dhe material arkival, i cili ishte destinuar për të dalë jashtë shtetit për t’u shkrirë. Në Vlorë kishte dy depo me letra të vjetra me dimensione 10x6m dhe 5x6m. Në sondazhin që iu bë, rezultoi se midis letrave të pavlera ka dhe materiale arkivistike të ndryshme, akte të financës, regjistra kadastrë, akte turqisht etj.<sup>18</sup>

Një formë tjetër e dëmtimit të dokumenteve ishte përdorimi i dokumenteve të vjetra për koncepte nga nëpunësit. Komiteti Ekzekutiv i Qytetit të Beratit më 1947 i shkruante Këshillit të Ministrave në lidhje me arkivat e vjetra se “...ky Komitet ngarkojë një nëpunës për të kontrolluar gjithë arshivat e vjetra të zyrave e ndërmarrjeve të ndryshme të këtij qyteti dhe në përfundim rezultoj se asnjë nga këto arshiva nuk ekziston, mbasi të gjitha aktet e tyre janë shkatërruar e djegur dhe një pjesë e tyre që kishte mbetur ashtë përdorur për konceptet”.<sup>19</sup>

Gjithashtu, më 1956 inspektorët e Drejtorisë së Arkivave i tërhiqnin vëmendjen Komitetit Ekzekutiv të KP të Qytetit të Tiranës “se dokumente

---

<sup>15</sup> AQSh, F. 490, V. 1947, D. 420, fl. 4.

<sup>16</sup> Mihallaq Pela, *Shërbimi arkivor në Shqipëri*, (Gervis, Tiranë, 2001), f. 22.

<sup>17</sup> Po aty, 22.

<sup>18</sup> Po aty, 46.

<sup>19</sup> AQSh, F. 490, V. 1947, D. 402, fl. 11.

shumë të rëndësishme zyrtare të kohës së paraçlirimit përdoren për koncepte”.<sup>20</sup>

Pavarësisht se u përcaktuan rregulla dhe kritere për kryerjen e procesit të ekspertizës, pati raste në arkivat e institucioneve në veprim ku u asgjësuan dhe u dogjën dokumente si “të pavlera”. Raste të tilla pati në arkivin e KE të Rrethit Mirditë më 1957, rast që u çua për ndjekje penale nga Drejtoria e Arkivave, pavarësisht se çështja u mbyll; në arkivin e KE të Rrethit Fier; në arkivin e Komitetit Shtetëror të Grumbullimeve në Tiranë; në arkivin e Ndërmarrjes të Bonifikimit në Durrës; në arkivin e Ndërmarrjes së Prodhimeve Farmaceutike; në arkivin e Drejtorisë së Përgjithshme të Centraleve Elektrike në Tiranë etj.<sup>21</sup>

Krahas masave dhe përpjekjeve që bëheshin nga Drejtoria e Arkivave për ruajtjen e dokumenteve, pati dhe asgjësime dokumentesh si në rastin e Gjykatës Popullore të Rrethit Berat më 1976 ku, pasi dënoi 4 persona të një familje për veprimtari armiqësore ndaj pushtetit popullor, gjykatësi urdhëroi me një vendim të veçantë djegien e tapive të tokave të kësaj familje “si akte pa vlerë gjyqësore dhe me përmbajtje kundërrevolucionare e antipopullore. Djegia u bë në sy të popullit që mori pjesë në gjykim”.<sup>22</sup>

Ndryshimi i sistemit politik dhe ekonomik në Shqipëri në fillim të viteve 90 pati pasoja dhe për arkivat e dokumentet. Pavarësisht se nuk pati dëmtime në arkivat e rretheve, që vareshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, në disa rrethe u dogjën dokumente të Kooperativave Bujqësore, Ndërmarrjeve Shtetërore apo të disa Këshillave të Bashkuar. Madje në disa godina dokumentet u nxorën jashtë, në mëshirë të fatit, për t’u përdorur si objekte banimi nga qytetarët. Rasti më i rëndë i dëmtimit të dokumenteve ndodhi në Shkodër më 2 prill 1991, ku u dogj plotësisht arkivi i Komitetit të Partisë dhe i Organizatave të Masave.

Por dëmtimin më të mëdha arkivat dhe dokumentet e patën në vitin 1997. Në këtë vit, si pasojë e trazirave u dëmtuan rëndë Arkivi i Rrethit Tropojë, i cili u dogj pothuajse i gjithi dhe shpëtuan vetëm dokumentet e arkivit të ish-Komitetit të PPSH-së, pjesërisht të organizatave të masave dhe regjistrat themeltarë të punonjësve të ndërmarrjeve. Dëmtime të rënda e pati dhe Arkivi i Rrethit Gramsh, ku përveç dëmtimeve të dokumenteve të këtij arkivi, pati dëmtime dhe të dokumentacionit të AQSh-së, të viteve 1945-1990, që ruhej në vendruajtjen Gramsh.

---

<sup>20</sup> AQSh, F. 507, V. 1956, D. 25, fl. 1.

<sup>21</sup> AQSh, F. 507, V. 1957, D. 7, fl. 2-4, 6, 9, 11-17, 21; AQSh, F. 507, V. 1960, D. 32, fl. 2, 3.

<sup>22</sup> Kastriot Dervishi, *Tapitë 'kundërrevolucionare e antipopullore' u dogjën para popullit*, <https://www.55news.al/dossier/item/242630-1976-tapite-kunderrevolucionare-e-antipopullore-u-dogjen-para-popullit> (vizituar për herë të fundit më 13.10.2020).

Dëme të pjesshme pati në dokumentet e arkivave të rretheve Lezhë, Pogradec, Berat, Mat, Përmet e Skrapar. Kjo për sa iu përket arkivave të rretheve që vareshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Dëmin më të madh e patën arkivat dhe dokumentet e institucioneve lokale ku u dogjën plotësisht ose pjesërisht arkivat e disa bashkive, të disa këshillave të rretheve, të prokurorive, gjykatave, bankave, të komisariateve të policisë, sigurimeve shoqërore, hipotekave, zyrave të përmbarimit, degëve të tatimtaksave, të degëve të thesarit e të doganave, dokumente të bibliotekave, të ndërmarreve e të drejtorive, të komunave etj.

Kjo është një pamje e pjesshme e dëmtimeve të dokumenteve dhe arkivave në vendin tonë në periudha të ndryshme. Në fund dua të shtoj se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave po punon për të paraqitur për shqyrtim dhe miratim përpara KLA të projektvendimit “Për evidentimin, vlerësimin, rigjetjen dhe përfshirjen në rrjetin arkivor kombëtar të dokumenteve RHK që gjenden jashtë tij”, ku Drejtoria e Inspektimit dhe Trajnimeve është struktura përgjegjëse për programin e rigjetjes së dokumenteve RHK, të cilat, sipas ligjit, janë pronësi e arkivave shtetërore dhe ndodhen të humbura, të vjedhura, ose të gjetura në mënyrë tjetër të jashtëligjshme në duart e subjekteve private.

### **Bibliografi:**

*Burime parësore:*

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë

*Burime dytësore:*

Dervishi, Kastriot. *Tapitë ‘kundërrevolucionare e antipopullore’ u dogjën para popullit*, <https://www.55news.al/dossier/item/242630-1976-tapite-kunderrevolucionare-e-antipopullore-u-dogjen-para-popullit> (vizituar për herë të fundit më 13.10.2020)

Loli, Ivan. *Historia e Arkivave në Shqipëri 1912-1944*, ShBL, Tiranë, 1999

Pela, Mihallaq. *Shërbimi arkivor në Shqipëri*, Gervis, Tiranë, 2001